



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË



BAILIFF OFFICERS

Nr. 1035 Prot
Nr.969.Regj

Tiranë, më datë 24.08.2021

URDHËR
PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE



Drejtuar : Qendrës Kombëtare të Bisnesit

Adresa : Tiranë

Pranë Zyrës Përmbaremore Private "Bailiff Officers" sh.p.k, është depozituar kërkesa e palës kreditore Banka OTP Albania sh.a. në datë 03.08.2021 së bashku me Urdhërin e Ekzekutimit Nr. 7280 datë 22.07.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lëshuar për kontratën për dhënie kredie me afat dhe/ose lehtësie garantuese letër kredi dhe/ose letër garanci nr. 9563 rep, nr. 3030 kol, datë 14.08.2013, *si dhe marrveshjet*: Marrveshje pengu mbi kuotat me nr. 9568 rep, nr. 3035 kol, datë 14.08.2013, Marrveshje për transferimin e të drejtave dhe pengut mbi kreditë dhe të ardhurat e arkëtushme nr. 9566 rep, nr. 3033 kol, datë 14.08.2013, Marrveshje mbi kolateralin financiar nr. 9565 rep, nr. 3032 kol, datë 14.08.2013, Marrveshje Siguruese nr. 9567 rep, nr. 3034 kol, datë 14.08.2013, dhe Kontrata e Hipotekes nr. 9564 rep, nr. 3031 kol, datë 14.08.2013, me pale:

- Kreditor: Banka OTP Albania sh.a
- Debitor: Shoqëria "TEODORI 2003" sh.p.k
- Dorranës: Faik Teodori, Shefikat Ngjela
- Hipotekues: Shoqëria "TEODORI 2003" sh.p.k
- Objekti: Kthim kredie

Në kushtet kur për ekzekutimin e Urdhërit të Ekzekutimit, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nuk është përmbushur detyrimi në mënyrë vullnetare, nga ana e zyrës përmbaremore duhet të kryhet vendosja e masës së sekuestros konservative në kuotat/aksionet e palës debitore.

Si në zbatim të neneve 527 e në vijim të K.Pr.Civile.

URDHËROJMË:

1-Vendosjen e masës së sekuestros konservative në kuotat/aksionet e palës debitore si dhe mbi të drejtat që rrjedhin nga zoterimi i këtyre kuotave duke ndaluar tjetërsimin dhe/ose disponimin e tyre si dhe, **mos kryerjen e asnjë veprimi tjetër qoftë dhe ndryshim adrese ndryshim administrator, depozitim bilanci etj.**

Dokumentacioni do të qëndrojë i bllokuar deri në një urdhër të dytë nga zyra përmbaremore private "Bailiff Officers" sh.p.k

- Shoqëria "TEODORI 2003" sh.p.k, me NUIS - K42301006L

2-Për veprimet apo mos veprimet tuaja duhet të na vini në dijeni shkresërisht brenda 5-ditëve, nga marrja dijeni.

3-Personat që bëhen pengesë, do të përgjigjen në bazë të nenit 606 të K.Pr.Civile, që parashikon vendosjen e sanksionit të gjobës si dhe nqs ka vënd dhe kallzimin penal në bazë të nenit 320 të Kodit Penal, për pengim të ekzekutimit.

4-Ky urdhër mbahet në 4 kopje, dhe u njoftohet palëve të cilat kanë të drejtën e ankimit në Gjykatë brenda 5 ditëve, nga marrja dijeni.

Zyra Përmbarimore Private "Bailiff Officers" sh.p.k
Përmbarues Gjyqësor Privat
Ilir DERVISHI

